				me të mirë të pikave të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në këtë zonë. Kërkesa do të përcillet te drejtoritë dhe institucionet kompetente për shqyrtim dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme, në mënyrë që banorëve të fshatrave të Hasit t'u ofrohen shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme.
14	1-Ne te gjitha kërkesat dhe ndërtimit te cilat behën te parashihen edhe kërkesat per persona me aftësi te kufizuara.	Resmije Rahmani	Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme dhe se ligjërisht të gjitha projektet që realizohen do të jenë të parapara që personat me aftësi të kufizuara të mos kenë probleme në qasje.
	2-Rregullimi i rrugës Beteja e Kabashit dhe te mundësohet qasja për personat me aftësi të kufizuara.		Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme dhe se ligjërisht të gjitha projektet që realizohen do të jenë të parapara që personat me aftësi të kufizuara të mos kenë probleme në qasje. Ky projekt synohet që realizohet përmes projekti: Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt në , Lidhja e Prizrenit, Arbana, Bajram Curri, Jeta e re, Kurilla, Kongresi i Manastirit, Poslisht, Zhur, Hoqë e Qytetit, Korishë, Drajçë, Gjonaj, Mazrek, Kojushë, Velezhë, Korishë, Malësi e re, Skorobisht, Randobravë, Krushë e Vogel, Nashec, Tupec dhe lokacione tjera me kodin: 54588.
15	1- Vendorsja/rregullimi i ujit te pijshëm ne fshatin Vlashnje .	Petrit Hoxhaj, kryetar i këshillit të fshatrave	Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët dhe synohet që përmes projekti: Rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellesit në pjesët kryesore të qytetit, Lidhja e Prizrenit, Arbanë, Tusus, Jeta e re, Bajram Curri, Kurillë, Petrovë, Zhur, Trepeticë, Malësi e re, Korishë, Gërçare, Jabllanicë, Sokorobisht, Serbicë e Eperme, Grazhdanik, Piranë, Krushë e Vogel, Zojz, Gjonaj dhe lokacionet tjera me kodin: 54603.
16	1-Vendorsja e ujit te pijshëm ne te gjithë fshatin pasi qe po kemi vetëm 10 min ujë në ditë.	Besmir Shala, kryetar i këshillit të fshatit Bilushë	Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët dhe synohet që përmes projekti: Rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellesit në pjesët kryesore të qytetit, Lidhja e Prizrenit, Arbanë, Tusus, Jeta e re, Bajram Curri, Kurillë, Petrovë, Zhur, Trepeticë, Malësi e re, Korishë, Gërçare, Jabllanicë, Sokorobisht, Serbicë e Eperme, Grazhdanik, Piranë, Krushë e Vogel, Zojz, Gjonaj dhe lokacionet tjera me kodin: 54603.
17	1-Te ndahet buxheti për realizimin e planeve të veprimt për komunitete.	Osman Osmanaj-OJQ Novo Concept.	Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme buxheti i ndarë për vitin 2026 nuk ka mundur të shpenzohet pasi që ka pasur tërheqje të mjeteve financiare nga përmbartuesi, do të planifikohet buxhet edhe për vitin 2027.
18	1-Te ndahet buxhet më shumë për projektin e ndërtimit të shtëpisë së kulturës për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptian.	Fatmir Menekshe-OJQ DrumishAsllano	Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme buxheti i ndarë për vitin 2026 nuk ka mundur të shpenzohet pasi që ka pasur tërheqje të mjeteve financiare nga përmbartuesi, do të planifikohet buxhet edhe për vitin 2027.
	2- Ndryshimi i rrjetit te kanalizimit ne rrugën Nysret Searsoj .		Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët dhe synohet që përmes projekti: Rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellesit në pjesët kryesore të qytetit, Lidhja e Prizrenit, Arbanë, Tusus, Jeta e re, Bajram Curri, Kurillë, Petrovë, Zhur, Trepeticë, Malësi e re, Korishë, Gërçare, Jabllanicë, Sokorobisht, Serbicë e Eperme, Grazhdanik, Piranë, Krushë e Vogel, Zojz, Gjonaj dhe lokacionet tjera me kodin: 54603.
19	1-Ndertimi i rrugës vetëm për shoqatën Hader dhe ndarja nga rruga e ambulantes.	Resmije Krasniqi shoqata Hader	Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët dhe synohet që përmes projekti: Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me kubeza trotuareve dhe shesheve, Lidhja e Prizrenit, Arbanë, Tusus, Jeta e re, Bajram Curri, Petrovë, Zhur, Malësi e re, Gërçare, Jabllanicë, Shpenadi, Sokorobisht, Grazhdanik, Piranë, Krushë e

	2-Dhenja e një lokali në lokacionin e Shatërvanit për shfrytëzimin e reklamimit të punëve të dorës që kryhen nga kjo shoqatë.		Pranohet	Vogel, Zojz, Caparcë, Vërmicë, Dobrushtë, Gjonaj, Lubiqevë dhe lokacionet tjera me kodin: 54596. Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për promovimin dhe mbështetjen e punëve të dorës të realizuara nga kjo shoqatë. Komisioni vlerëson se ofrimi i një lokali në lokacionin e Shatërvanit do të mundësonte ekspozimin dhe reklamimin e produkteve artizanale, duke kontribuar në promovimin e punës së shoqatës, ruajtjen dhe kultivimin e traditës dhe artizanatit, si dhe në krijimin e mundësive më të mira për prezantimin e produkteve para qytetarëve dhe vizitorëve. Në këtë drejtim, Komisioni e mbështet kërkesën dhe rekomandon që mundësia për ofrimin e një hapësire të përshtatshme në lokacionin e Shatërvanit të shqyrtohet nga organet dhe drejtoritë përkatëse të Komunës, në përputhje me mundësitë dhe procedurat ligjore në fuqi.
20	1- Nderimi i murit të varrezat dhe largimi i uzurpatorëve nga vendi i varrezave.	Ramë Himaj , kryetar i keshillit të fshatrave Romaj dhe Lukinjë	Adresohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët, veçanërisht për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e hapësirës së varrezave. Komisioni ka vlerësuar nevojën për ndërhyrje në rregullimin dhe ndërtimin e murit rrethues të varrezave, si dhe për ndërmarrjen e masave për lirin e hapësirës së varrezave nga uzurpimet eventuale. Kërkesa do t'u përcillet institucioneve dhe drejtorive kompetente për shqyrtim dhe veprim në përputhje me kompetencat dhe procedurat ligjore, me qëllim që hapësira e varrezave të mbrohet, të rregullohet dhe të shfrytëzohet në mënyrë të denjë nga komuniteti.
	2-Rregullimi i sistemit të ujit të pijes.		Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët dhe synohet që përmes projekti: Rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellesit në pjesët kryesore të qytetit, Lidhja e Prizrenit, Arbanë, Tusus, Jeta e re, Bajram Curri, Kurillë, Petrovë, Zhur, Trepetnicë, Malësi e re, Korishë, Gërçare, Jabllanicë, Sokorobisht, Sërbicë e Eperme, Grazhdanik, Piranë, Krushë e Vogel, Zojz, Gjonaj dhe lokacionet tjera me kodin: 54603.
	3-Rregullimi i proçkës.		Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët dhe synohet që përmes projekti: Rehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellesit në pjesët kryesore të qytetit, Lidhja e Prizrenit, Arbanë, Tusus, Jeta e re, Bajram Curri, Kurillë, Petrovë, Zhur, Trepetnicë, Malësi e re, Korishë, Gërçare, Jabllanicë, Sokorobisht, Sërbicë e Eperme, Grazhdanik, Piranë, Krushë e Vogel, Zojz, Gjonaj dhe lokacionet tjera me kodin: 54603.
	4-Rregullimi i ndriçimit publik.		Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët dhe synohet që përmes projekti: Instalimi i ndriçimit publik në Ortokoll, Bajram Curr, Tusus, Arbanë, Jeta e re", pjesët kryesore të qytetit, Dardania, Kurilla, Piranë, Zhur, Gjonaj, Hoqë e Qytetit, Landovicë, Randobravë, Vlashnje, Lybiqevë, Lutogllavë, Dobrushtë, Vërmicë, Muradem, Mazrek, Planejë, Kojushë, Grazhdanik, Krushë e Vogel, Kraj, Velezhë, Caparcë dhe lokacionet tjera me kodin: 54586
	5-Pastrimi i kanalizimit në lagjen Selmanaj.		Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët dhe synohet që përmes projekti: ehabilitimi i kanalizimit dhe ujësjellesit në pjesët kryesore të qytetit, Lidhja e Prizrenit, Arbanë, Tusus, Jeta e re, Bajram Curri, Kurille, Petrovë, Zhur, Trepetnicë, Malësi e re, Korishë, Gërçare, Jabllanicë, Sokorobisht, Sërbicë e Eperme, Grazhdanik, Piranë, Krushë e Vogel, Zojz, Gjonaj dhe lokacionet tjera me kodin: 54603.

21	1-Rregullimi i rrugës me kubëza (rreth 200m gjatësi dhe 4 m gjerësi.	Leotrim Dervishaj , banor i Lagjes Bajram Curri-rruga Brigada 125-Prizren (Kërkesë e pranuar në formë elektronike)	Pranohet	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për banorët dhe synohet që përmes projekti: Rehabilitimi dhe ndertimi i rrugëve me kubëza ,trotareve dhe shesheve; Lidhja e Prizrenit, Arbanë, Tusus, Jeta e re, Bajram Curri, Petrovë, Zhur, Malësi e re, Gërmaqare, Jabllanicë, Shpenadi,Sokorobisht, Grazhdanik, Piranë, Krushë e Vogel, Zojz, Caparçe, Vermice, Dobrushtë, Gjonaj, Lubigevë dhe lokacionet tjera me kodin: 54596.
22	1-Kërkesë për mbështetje të hapjes së një Qendëre moderne Gaming & Esports në Prizren, me kapacitet prej 30-50 PC-ve.	Bediz Fisari	Pjesërisht	Komisioni ka mbajtur takimin për shqyrtimin e kërkesave dhe ka vlerësuar se kërkesa është e rëndësishme për të rinjtë e Komunës së Prizrenit. Pas shqyrtimit, Komisioni ka vendosur që kërkesa për mbështetjen e hapjes së Qendrës Gaming & Esports të miratohet pjesërisht, në përputhje me mundësitë dhe kapacitetet e Komunës.

P.S

Për shkak të ekzekutimit të mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Prizrenit, i realizuar nga Ministria e Financave dhe Thesari përmes procedurave të përmbarimit, kapaciteti financiar i komunës është zvogëluar ndjeshëm. Kjo situatë ka krijuar vështirësi në zbatimin e prioritetëve të planifikuara buxhetore.

Si pasojë, ekziston mundësia që një pjesë e projekteve të parapara në buxhetin e vitit 2027 të mos realizohen brenda afateve të planifikuara ose të shtyhen për një periudhë të mëvonshme, në varësi të gjendjes financiare dhe mjeteve që do të jenë në dispozicion të komunës.

Shkurtesat:

F-Femra, M-Meshkuj, T-Totali.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e grupit punues,
2. Njoftimin për mbajtjen e dëgjimit publik,
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në dëgjim publik.

Raporti është përgatitur nga anëtarët e komisionit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 44, lidhur me nenin 49 të Ligjit nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 20/2016), Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2024 për Administratë të Hapur në Komuna dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për organizimin dhe planifikimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2027 dhe parashikimet për vitin 2028-2029 në Komunën e Prizrenit. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:

- 1.1. Levent Bush,.....kryesues i grupit,
- 1.2. Lulzim Sulejmani,.....zv. kryesues i grupit,
- 1.3. Gjafer Ponik,.....anëtar, procesmbajtës,
- 1.4. Ymer Berisha,.....anëtar,
- 1.5. Halil Lika,.....anëtar,
- 1.6. Fisnik Minci,.....anëtar,
- 1.7. Arbër Krasniqi,.....anëtar,
- 1.8. Alban Krasniqi,.....anëtar,
- 1.9. Arlinda Rama,.....anëtare,
- 1.10. Dafina Ukallo,anëtare,
- 1.11. Shpejtim Rramanaj,.....anëtar,
- 1.12. Haziz Krasniqi,.....anëtar,
- 1.13. Besarta Caka,.....anëtare.

2. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij vendimi ndër të tjera janë edhe:

- 2.1. Identifikimi i grupeve të qytetarëve përmes përdorimit të bazës së të dhënave komunale të grupeve të interesit, përgatitja e planit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe buxhetin vjetor të Komunës së Prizrenit, duke përfshirë në mes të tjerash përcaktimin e numrit të dëgjimeve buxhetore, vendit dhe kohës, etj., përgatit materiallet që janë të nevojshme gjatë dëgjimeve buxhetore, si: ftesa të personalizuar, (nëse konsiderohet e nevojshme) apo ato që

publikohen në ueb faqe e rrjete sociale të Komunës, modelin e procesverbalit të takimit, listën e pjesëmarrësve, etj.,. Përgatit informacione për buxhetin që do ti prezantohen qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore (përfshirë buxhetin në dispozicion për projekte të reja), në një format të vizualizuar dhe lehtë të kuptueshëm për qytetarët.

2.2. Prezantimin e informacioneve të buxhetit (me theks të veçantë në paraqitjen transparente të buxheteve të disponueshme për konsultim me qytetarët për projekte të reja nga kategoria e investimeve kapitale), ndarja e listave të pjesëmarrësve për nënshkrim, mbajtja e procesverbaleve të takimit, moderimi dhe fasilitimi/lehtësimi i dëgjimit buxhetor (me theks të veçantë në nxitjen e diskutimit dhe pranimin e ideve dhe kërkesave nga qytetarët, e po ashtu në nxitjen e validimit të kërkesave të qytetarëve nga komuniteti i pranishëm në dëgjim buxhetor, sidomos atyre që në bazë të argumentimit konsiderohen se janë prioritare dhe urgjente për tu realizuar).

2.3. Përpilimin e kriterëve/arsyeve për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe kategorizimit e prioritizimit për pranimin dhe refuzimin e tyre, shqyrtimin e të gjitha kërkesave të pranura gjatë dëgjimeve buxhetore dhe të tjera që pranohen me shkrim (rrjete sociale, email, ueb faqe) apo forma të tjera si takime të rregullta me Kryetarin apo të ngjashme, hartimin e një raporti të detajuar të konsultimeve publike ku evidentohen dhe elaborohen të gjitha kërkesat e pranura të qytetarëve dhe jo vetëm ato të pranura fizikisht gjatë dëgjimeve buxhetore, publikimi i raportit të konsultimeve publike në faqen e internetit të komunës dhe sipas kërkesave dhe afateve kohore të Udhëzimit Administrativ për Administratë të hapur.

3. Obligohet Grupi Punues dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Grupit Punues,
 - Arkivës së Kryetarit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës - Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 438/26 Dt. 10.09.2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Procesverbali i dëgjimit publik për Buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin 2027 i organizuar nga Kuvendi Komunal

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, si dhe Rregulloren Nr. 01/2025 për Transparencë në Komunën e Prizrenit, si dhe me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, Kuvendi Komunal i Prizrenit organizoi dëgjim publik me gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit për shqyrtimin dhe diskutimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2027 dhe planifikimeve buxhetore për vitet 2028/2029.

Qëllimi i këtij dëgjimi publik ishte informimi i qytetarëve dhe palëve të interesit lidhur me orientimet dhe prioritetet kryesore buxhetore të Komunës, si dhe mbledhja e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të tyre, me synim që procesi i planifikimit të buxhetit të jetë sa më transparent, efikas, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me nevojat dhe prioritetet e komunitetit.

Gjatë dëgjimit publik, qytetarët patën mundësi të shprehin kërkesat dhe shqetësimet e tyre, si dhe të paraqesin propozime konkrete për investime dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Diskutimet u fokusuan në identifikimin e prioritetëve zhvillimorë në fusha të ndryshme, përfshirë infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, shërbimet publike, zhvillimin ekonomik lokal dhe fusha të tjera me interes për qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Ky procesverbal hartohet me qëllim të dokumentimit të rrjedhës së dëgjimit publik, evidentimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të interesit, si dhe pasqyrimin të kontributit të tyre përmes propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura gjatë takimit.

Njëkohësisht, procesverbali shërben si dokument zyrtar për transparencën institucionale dhe llogaridhënien publike, ndërsa kontributet e paraqitura do të merren në konsideratë gjatë procesit të shqyrtimit dhe finalizimit të Buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe planifikimeve për vitet 2028/2029.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **02:09.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/Njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-Buxhetin-e-Komunes-se-Prizrenit-per-vitin-2027-Shq-Tur-Bosh.pdf>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-komunes-se-prizrenit-per-vitin-2027/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/19GaJ2hhJH/>

Memorandumi shpjegues:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/Memorandum-shpjegues-per-degjimin-publik-per-buxhetin-e-vitit-2027-i-organizuar-nga-Kuvendi-Komunal.pdf>

Dëgjimi është mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe ka filluar në orën **10:13**.

Hapja e dëgjimit e dëgjimit publik është bërë nga Haziz Krasniqi, zyrtar i larë për Informim dhe Raportim duke thënë se jemi sot në këtë dëgjim publik buxhetor për Projekt-buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin 2027, i organizuar nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit. Ky dëgjim zhvillohet pas pranimit dhe dorëzimit të propozim-buxhetit nga Kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj.

Organizimi i këtij dëgjimi publik bëhet me qëllim të rritjes së transparencës, informimit të qytetarëve dhe përfshirjes së tyre në procesin e planifikimit dhe miratimit të buxhetit komunal.

Dëgjimi i sotëm është i karëti me radhë dhe i fundit për këtë vit.

Rrjedha e dëgjimit publik do të jetë si në vijim:

Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Simir Krasniqi;

Prezantimi i Projektbuxhetit nga zyrtarët e Drejtorisë së Financave;

Diskutimi dhe parashtrimi i pyetjeve, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët dhe të pranishmit.

Për mbajtjen e këtij dëgjimi publik do të mbahet procesverbal dhe do të hartohet raport me të gjitha detajet, dhe përgjigje do tju jepet të gjitha kërkesave të cilët bëhen nga ana juaj.

Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Simir Krasniqi i cili ka thënë se pas pranimi të Projekt - Buxhetit nga Kryetari Komunës zot.Shaqir Totaj për vitin 2027 dhe planifikimet për vitet 2028-2029.

Para miratimit në Kuvend nga antarët e Kuvendit në aspektin ligjor detyrohem që unë si Kryesues i Kuvendit të organizoj degjimin publik buxhetor me Kuvedarë për Projekt - Buxhetin e Komunës për vitin 2027 planifikimet për vitet 2028 - 2029

Pas shumë degjimeve publike me Komunitetin, Kryetarë të Bashkësive lokale, OJQ, Biznese. Ku janë degjuar dhe marrë të gjitha kërkesat dhe nevojat e tyre për përfshirjen e projekteve të tyre ne Projekt-Buxhetin e vitin 2027 ku është bërë më mira e mundëshme duke pasur një Buxhet gjithëpërfshirës.

Ju e dini edhe vështërsitë e Komunës me permbaruesin ku Komunës së Prizrenit vetëm për vitin 2026 janë marrë 20 mil.Euro nga Kontrata Kolektive në arsim që kjo pagesë është dashur te kryet nga Ministria e Arsimit dhe jo ti merren mjetet nga projektet kapitale të Komunës.

Por si do që të jetë falenderojë Kryetarin, Drejtorët, ZKF që kanë bërë më të mirën e mundëshme që ta finalizojnë Projekt - Buxhetin për vitin 2027 dhe planifikimet për vitet 2028-2029. Ky buxhet të jetë gjithëpërfshirës.

Për më tepër i kemi edhe Drejtorët dhe ZKF ketu për qdo pyetje te juajen mund të ju përgjigjen.

Prezantimi i Projekt-buxhetit për vitin 2027 u bë nga zyrtarët e Drejtorisë së Financave, ndërsa para të pranishmëve Projekt-buxhetin e prezantoi Zyrtari Kryesor Financiar, Lulzim Sylejmani. Ai bëri të ditur se buxheti i Komunës së Prizrenit për vitin 2027 parashihet të jetë në vlerë prej 79,118,940.00 €, duke paraqitur në mënyrë të detajuar strukturën dhe ndarjen e mjeteve buxhetore sipas kategorive kryesore të shpenzimeve.

Sipas prezantimit, 32,588,843.00 € janë planifikuar për kategorinë Paga dhe mëditje, 15,730,224.00 € për Mallra dhe shërbime, ndërsa për Shpenzime komunale janë paraparë 1,405,299.00 €. Për kategorinë Subvencione dhe transfere janë planifikuar 5,713,459.00 €, ndërsa 23,681,115.00 € janë ndarë për Shpenzime kapitale, të cilat përfshijnë investimet dhe projektet kapitale të Komunës.

Gjatë prezantimit u theksua rëndësia e procesit të dëgjimeve publike buxhetore, përmes të cilave qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve, organizatat dhe grupet e interesit kanë pasur mundësinë të paraqesin kërkesat dhe propozimet e tyre.

Kërkesat e qytetarëve:

Faik Berisha-kryetar i këshillit të fshatit Landovicë

- 1-Rregullimi i 1 kilometer rruge nga market Laja e mahalla e Gashve e cila do te lidhet me Hasin;
- 2-Hapja e rrugeve fushore;
- 3-Pastrami i shtratit te lumit ne fshatin Landovic.

Almir Bajrami-kryetar i këshillit të fshatrave Mushnikovë, Sreckë, Gornje Sello, Prevallë

- 1-Ndertimi i shtepis se cultures ne fshatim Mushnikove;
- 2-Ndarja e tensionit te larte nga fshati Gornjosell me Prevallen.

Kreshnik Qollaku-banor i fshatit Bregdri

- 1-Rregullimi dhe intervenimi ne objektin e shkollës;
- 2-Ndertimi i trotuarit;
- 3-Ndertimi i fushës sportive;
- 4-Mungesa e rrymës .

Bujar Pulaj, kryetar i këshillit të fshatrave Vërmicë, Shkozë, Dobrusht

- 1-Rehabilitimi i rrjetit te ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve ne Vermic, Shkoz dhe Dobrusht;
- 2-Ndriwimi publik ne Vermic;
- 3-Rregullimi i kanalizimit ne shkollën e fshatit Shkozë;
- 4-Ndertimi i një rezervari për ujin e pijshëm ne Dobrusht.

Erion Markaj, banor i lagjes Anton Qeta në Prizren

- 1-Rregullimi i rrugëve Pal Paluca, Anton Qeta dhe tjerave për rreth;
- 2-Regullimi dhe vendosja e ndriçimit publik;
- 3-Parkimet jo te rregullta te cilat po e bllokojnë hyrjen ne rrugica.

Simon Veseli, kryetar i këshillit të fshatrave Velezhë, Sërbicë e Epërme, Trepeticë, Shpenadi dhe Smaç

- 1-Pastrimi i shtratit te lumit nga Shepnadija, Velezh dhe Capare;
- 2-Ndriçimi publik ne te gjitha këto fshatrat;
- 3-Meremetimi i rrugëve te dëmtuara nga KEDS-i;
- 4-Hapja e rrugëve fushore ne te gjitha këto fshatra;
- 5-Shtrimi i rrugëve me kabëza ne gjatësi pre 1000-1200 metra;
- 6-Vendosja e kanalizimit ne gjatësi 1000-1200 metra .

Marte Prekpalaj kryetare e këshillit të fshatrave Zym, Karashëngjergj, Krajk dhe Bregdri

- 1-Ndertimin e trotuarit;
- 2-Ndertimin e kanalizimit;
- 3-Ndertimin e oborrit te shkollës;
- 4-Ndertimin e rrugëve;
- 5-Siguria ne fshatrat e Hasit;
- 6-Shendetesia te jet ne nivel per keto fshatra.

Resmije Rahmani

- 1-Ne te gjitha kërkesat dhe ndërtimit te cilat behën te parashihen edhe kërkesat per persona me aftësi te kufizuara;
- 2-Rregullimi i rrugës Beteja e Kabashit dhe te mundësohet qasja për personat me aftësi të kufizuara.

Petrir Hoxhaj, kryetar i këshillit të fshatrave

- 1- Vendosja/rregullimi i ujit te pijshëm ne fshatin Vlashnje .

Besmir Shala, kryetar i këshillit të fshatit Billushë

- 1-Vendosja e ujit te pijshëm ne te gjithë fshatin pasi qe po kemi vetëm 10 min ujë në ditë.

Osman Osmanaj-OJQ Novo Concept

- 1-Të ndahet buxheti për realizimin e planeve të veprimit për komunitete.

Fatmir Menekshe-OJQ DrumishAsllano

- 1-Të ndahet buxhet më shumë për projektin e ndërtimit të shtëpisë së kulturës për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptian;
- 2- Ndryshimi i rrjetit te kanalizimit ne rrugën Nysret Searsoj .

Resmije Krasniqi shoqata Hader

- 1-Ndertimi i rrugës vetëm për shoqatën Hader dhe ndarja nga rruga e ambulantes;
- 2-Dhenja e një lokali ne lokacionin e Shatërvanit për shfrytëzimin e reklamimit te punëve te dorës qe kryhen nga kjo shoqatë.

Ramë Himaj, kryetar i këshillit të fshatrave Romaj dhe Lukinjë

- 1- Nderimi i murit te varrezat dhe largimi i uzurpatorëve nga vendi i varrezave;
- 2-Rregullimi i sistemit të ujit të pijes;
- 3-Rregullimi i proçkës;
- 4-Rregullimi i ndriçimit publik;
- 5-Pastrimi i kanalizimit në lagjen Selmanaj.

Ilami Axhillari, Kryetari i Këshillit Lokal "10 Qershor" në Prizren

1- Kërkesë 1(lagjja "Bylbyldere")

Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore, kanalizimi për ujërat atmosferik – fekale, si dhe ndërrimi i gypit të asbestit i cili furnizon banorët me ujë të pijes, (të gjithë bashkë me gjatësi rreth 600 m), në rrugët

1. "Xhavit Bajraktari"
2. "Anif Muji"

2- Kërkesë (lagjja nënkalaja):

Rregullimi i rrugëve, trotuarëve, infrastrukturës nëntokësore, ndërtimi i pushimoreve dhe vendosja e disa ulëseve (të gjitha bashkë me gjatësi rreth 700 m): në rrugët

1. "Pal Paluca"
2. "Mentor Krasniqi"
3. "Anton Çetta"
4. "Lazër Lumezi"
5. "Shën Albani"

Është me rëndësi që në disa vende të këtyre rrugëve të vendosen mbështetëset anësore për këmbësorë për shkak të pjerrtësisë të madhe të terrenit dhe rrezikut të lëvizjes së njerëzve të moshuar.

3- Kërkesë (lagjja bylbyldere)

Rregullimi i i tri rrugëve me kubza betoni, (të gjitha bashkë me gjatësi rreth 500 m), në rrugët:

- "Anif Muji"
- "Martirët e Struzhës"

4- Kërkesë (lagjja Bylbyldere)

Rregullimi i kanalit (prockë) për rrjedhjen e ujërave atmosferike me gjatësi 250 m, në Rugën “Anif Muji”

Dëgjimi ka përfunduar në orën 11:15.

Për të siguruar transparencë dhe informim të plotë të publikut, Projekt Buxheti u është shpërndarë në formë fizike të gjithë pjesëmarrësve në dëgjim. Njëkohësisht, këto dokumente janë publikuar në faqen zyrtare dhe kanë qenë të qasshme për të gjithë qytetarët përmes vegëzave përkatëse:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën dëgjim publik dhe financat: <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=> , <https://prizren.rks-gov.net/financa/> dhe <https://prizren.rks-gov.net/qarkorja-buxhetore/> : <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti> .

Me 10.09.2026, është mbajtur takimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e dëgjimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/kuvendi-komunal-i-prizrenit-mbajti-degjim-publik-per-buxhetin-e-vitit-2026/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1EqzLSobkN/>

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 202/26 Dt. 05.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 44, lidhur me nenin 49 të Ligjit nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 20/2016), Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2024 për Administratë të Hapur në Komuna dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për organizimin dhe planifikimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2027 dhe parashikimet për vitin 2028-2029 në Komunën e Prizrenit. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:

- 1.1. Levent Bush,.....kryesues i grupit,
- 1.2. Lulzim Sulejmani,..... zv. kryesues i grupit,
- 1.3. Gjafer Ponik,.....anëtar, procesmbajtës,
- 1.4. Ymer Berisha,.....anëtar,
- 1.5. Halil Lika,.....anëtar,
- 1.6. Fisnik Minci,.....anëtar,
- 1.7. Arbër Krasniqi,.....anëtar,
- 1.8. Alban Krasniqi,.....anëtar,
- 1.9. Arlinda Rama,.....anëtare,
- 1.10. Dafina Ukallo,anëtare,
- 1.11. Shpejtim Rramanaj,.....anëtar,
- 1.12. Haziz Krasniqi,.....anëtar,
- 1.13. Besarta Caka,.....anëtare.

2. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij vendimi ndër të tjera janë edhe:

- 2.1. Identifikimi i grupeve të qytetarëve përmes përdorimit të bazës së të dhënave komunale të grupeve të interesit, përgatitja e planit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe buxhetin vjetor të Komunës së Prizrenit, duke përfshirë në mes të tjerash përcaktimin e numrit të dëgjimeve buxhetore, vendit dhe kohës, etj., përgatit materialit që janë të nevojshme gjatë dëgjimeve buxhetore, si: flesa të personalizuar, (nëse konsiderohet e nevojshme) apo ato që

publikohen në ueb faqe e rrjete sociale të Komunës, modelin e procesverbalit të takimit, listën e pjesëmarrësve, etj... Përgatit informacione për buxhetin që do ti prezantohen qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore (përfshirë buxhetin në dispozicion për projekte të reja), në një format të vizualizuar dhe lehtë të kuptueshëm për qytetarët.

- 2.2. Prezantimin e informacioneve të buxhetit (me theks të veçantë në paraqitjen transparente të buxheteve të disponueshme për konsultim me qytetarët për projekte të reja nga kategoria e investimeve kapitale), ndarja e listave të pjesëmarrësve për nënshkrim, mbajtja e procesverbaleve të takimit, moderimi dhe fasilitimi/lehtësimi i dëgjimit buxhetor (me theks të veçantë në nxitjen e diskutimit dhe pranimin e ideve dhe kërkesave nga qytetarët, e po ashtu në nxitjen e validimit të kërkesave të qytetarëve nga komuniteti i pranishëm në dëgjim buxhetor, sidomos atyre që në bazë të argumentimit konsiderohen se janë prioritare dhe urgjente për tu realizuar).
- 2.3. Përpilimin e kriterëve/arsyëve për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe kategorizimit e prioritizimit për pranimin dhe refuzimin e tyre, shqyrtimin e të gjitha kërkesave të pranura gjatë dëgjimeve buxhetore dhe të tjera që pranohen me shkrim (rrjete sociale, email, ueb faqe) apo forma të tjera si takime të rregullta me Kryetarin apo të ngjashme, hartimin e një raporti të detajuar të konsultimeve publike ku evidentohen dhe elaborohen të gjitha kërkesat e pranura të qytetarëve dhe jo vetëm ato të pranura fizikisht gjatë dëgjimeve buxhetore, publikimi i raportit të konsultimeve publike në faqen e internetit të komunës dhe sipas kërkesave dhe afateve kohore të Udhëzimit Administrativ për Administratë të hapur.
3. Obligohet Grupi Punues dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Grupit Punues,
- Arkivës së Kryetarit.



NJOFTIM PUBLIK

Për organizimin e dëgjimit publik për Buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin 2027.

Ky dëgjim publik buxhetor organizohet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Data: 10 Shtator 2026.

Vendi: Salla e Mbledhjeve e Kuvendit të Komunës (Shtëpia e Bardhë).

Ora: 10:00.



Të nderuar qytetarë,

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, si dhe Rregulloren Nr. 01/2025 për Transparencë në Komunën e Prizrenit, ju ftojmë të merrni pjesë në Dëgjimin Publik Buxhetor për Buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe planifikimet për vitet 2028–2029, i cili u dedikohet të gjithë qytetarëve të Komunës së Prizrenit.

Ky dëgjim publik buxhetor organizohet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, pas pranimi të Projekt buxhetit nga Kryetari i Komunës, z. Shaqir Totaj.

Informacionet për qarkoret buxhetore për vitin 2027 dhe planifikimet për vitet 2028-2029, si dhe me Projekt buxhetin e Komunës së Prizrenit, mund t'i gjeni në vegzat e mëposhtme: <https://prizren.rks-gov.net/financa/> , <https://prizren.rks-gov.net/buxheti-komunal/> , <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti> .

Dëgjimi publik mbahet me datë: **10 shtator 2026** në orën **10:00**, në sallën e mbledhjeve e Kuvendit Komunal të Prizrenit (Shtëpia e Bardhë).

Kërkesat, komentet dhe sugjerimet, qytetarët mund t'i dërgoni edhe përmes këtyre emailave: Lulzim.N.Sylejmani@rks-gov.net , Halil.Lika@rks-gov.net , Gjafer.Ponik@rks-gov.net , Arber.Krasniqi@rks-gov.net , Haziz.Krasniqi@rks-gov.net , si dhe në formë fizike në këtë adresë: Rruga Adem Jashari Nr 275 Prizren 20000 (Shtëpia e Bardhë) nga data: **02.09.2026** deri me datë: **15.09.2026**.

Kontributi juaj është i rëndësishëm për një buxhet më transparent dhe sa më afër nevojave të qytetarëve.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës, Presidenti Opštine
Belidije Prizreni

01 Nr. 402/26 Dt. 02.09.2026

Yllë Berisha
Udhëheqës i shërbimit për Komunikim me Publikun



JAVNO OBAVESTENJE

O organizovanju javne rasprave o Budžetu Opštine Prizren za 2027. godinu.

Ova javna budžetska rasprava organizuje se od strane članova Skupštine Opštine Prizren.

Datum: 10.09.2026.

Vendi: Sala za sednice opštinske skupštine (Bela kuća).

Vreme: 10:00.

Dragi građani,

Na osnovu Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Zakona br. 03/L-048 o upravljanju javnim finansijama i odgovornosti, Statuta opštine Prizren br. 01/011-5643 od 15.10.2008. godine, Administrativnog uputstva (MLGA) br. 04/2023 o otvorenoj administraciji u opštinama, kao i Uredbe br. 01/2025 o transparentnosti u opštini Prizren, pozivamo vas da učestvujete u javnoj budžetskoj raspravi o budžetu opštine Prizren za 2027. godinu i planovima za 2028–2029. godinu, koja je posvećena svim građanima opštine Prizren.

Ovu javnu raspravu o budžetu organizuju odbornici Skupštine opštine Prizren, nakon što je gradonačelnik, gospodin Šaćir Totaj, prihvatio Nacrt budžeta.

Informacije o budžetskim cirkularima za 2027. godinu i planovima za 2028–2029. godinu, kao i Nacrt budžeta opštine Prizren, mogu se naći na sledećim linkovima: <https://prizren.rks-gov.net/financa/>, <https://prizren.rks-gov.net/buxheti-komunal/>, <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti>.

Građani takođe mogu slati zahteve, komentare i sugestije putem ovih imejllova: Lulzim.N.Sylejmani@rks-gov.net, Halil.Lika@rks-gov.net, Gjafer.Ponik@rks-gov.net, Arber.Krasniqi@rks-gov.net, Haziz.Krasniqi@rks-gov.net, si i u fizičkom obliku na ovoj adresi: Ulica Adem Jašari br. 275 Prizren 20000 (Bela kuća) od datuma: **02.09.2026.** do datuma: **15.09.2026.**

Vaš doprinos je važan za transparentniji budžet i budžet bliži potrebama građana.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunes - Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 402/26 02.09.2026

Ymer Berisha
Rukovodilac Jedinice za Odnose sa Javnošću



KAMUOYU DUYURUSU

2027 Yılı Prizren Belediyesi Bütçesi için kamuoyu istişare toplantısının düzenlenmesi hakkında.

Bu bütçe kamuoyu istişare toplantısı, Prizren Belediyesi Meclisi üyeleri tarafından düzenlenmektedir.

Data: 10.09. 2026.

Yer:

Prizren Belediye Meclisi Toplantı Salonu (Beyaz Ev).

Saat: 10:00.

KOMUNA E KOCOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunesë, Predsednik Opštine
Prizreni, Prizreni
01
Nr. 402/26
Dt. 02.09.2026

Değerli vatandaşlarımız,

Yerel Özyönetim Hakkında 03/L-040 Sayılı Kanun, Kamu Maliyesinin Yönetimi ve Sorumluluklar Hakkında 03/L-048 Sayılı Kanun, 15.10.2008 tarihli ve 01/011-5643 Sayılı Prizren Belediyesi Statüsü, Belediyelerde Açık Yönetim Hakkında (YBYA) 04/2023 Sayılı İdari Talimat ve Prizren Belediyesi'nde Şeffaflık Hakkında 01/2025 Sayılı Yönetmelik uyarınca, Prizren Belediyesi'nin 2027 yılı bütçesi ile 2028–2029 yıllarına ilişkin bütçe planlamalarının ele alınacağı ve Prizren Belediyesi'nin tüm vatandaşlarına yönelik düzenlenecek Bütçe Kamu Duruşmasına katılmaya davet ediyoruz.

Bu bütçe kamuya açık istişare toplantısı, Belediye Başkanı Sayın Shaqir Totaj tarafından bütçe taslağının sunulmasının ardından, Prizren Belediye Meclisi üyeleri tarafından düzenlenmektedir.

2027 yılı bütçe genelgeleri ve 2028–2029 yıllarına ilişkin planlamalar ile Prizren Belediyesi bütçe taslağına dair bilgileri aşağıdaki bağlantılarda bulabilirsiniz: <https://prizren.rks-gov.net/financa/> , <https://prizren.rks-gov.net/buxheti-komunal/> , <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti> .

Vatandaşlar, talep, yorum ve önerilerini aşağıdaki e-posta adresleri aracılığıyla da iletebilirler: Lulzim.N.Sylejmani@rks-gov.net , Halil.Lika@rks-gov.net , Gjafer.Ponik@rks-gov.net , Arber.Krasniqi@rks-gov.net , Iljaziz.Krasniqi@rks-gov.net , Ayrıca, fiziki olarak şu adrese de teslim edilebilir: Adem Jashari Caddesi No: 275, Prizren 20000 (Beyaz Ev), tarih: **02.09.2026** ile **15.09.2026** tarihleri arasında.

Katkılarınız, daha şeffaf ve vatandaşların ihtiyaçlarına daha yakın bir bütçenin hazırlanması açısından büyük önem taşımaktadır.

Ymer Berisha
Halkla İlişkiler Birimi Başkanı



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E PRIZRENIT • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunesë, Presidenti i Opštine
Belediye Başkanı

01 N. 399/26 D. 31.08.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



KOMUNA E PRIZRENIT
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

PROPOZIM BUXHETI I KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2027

Korrik, 2026

PROPOZIM BUXHETI I KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2027, PARASHIKIM PËR 2028 -2029

Procesi i hartimit të Projekt-Buxhetit 2027-2029

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 24, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nenet 7 dhe 8, si dhe Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në qarkoret 2027/01 dhe 2027/02 të lëshuara nga MFPT-ja dhe në Kornizën Afatmesme të Buxhetit 2027–2029, është hartuar Propozimi i Buxhetit Komunal për vitet 2027–2029, të cilin Kryetari, pas shqyrtimit, ia propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Asamblesë Komunale për miratim final, në afatin e paraparë me ligj (30.09.2026).

Procesi i hartimit të propozim-buxhetit me të drejtë konsiderohet si njëri ndër proceset më të rëndësishme për një organizatë buxhetore, për faktin se nga ai proces hartohet buxheti si një ligj, i cili përmban planin e financimit të të gjitha shpenzimeve në kategoritë përkatëse.

Organizata jonë buxhetore (622) ka zhvilluar procesin e hartimit të buxhetit për vitet 2027–2029, në harmoni të plotë me udhëzimet e pranuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes Qarkoreve Buxhetore 2027/01 dhe 2027/02, si dhe në zbatim të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me qëllim që finalizimi i tij të jetë në përputhje me interesat e qytetarëve të komunës sonë, për aq sa kanë lejuar kufijtë e limituar të financimit.

Propozim-buxheti, përveç burimeve të financimit apo burimeve të bërjes së tij, përmban edhe projektionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale, të shpërndara në pesë kategori ekonomike të shpenzimeve, si dhe në programet dhe nënpogramet e tij.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka hartuar qarkoret buxhetore bazuar në të dhënat e përcaktuara nga Komisioni i Granteve i cili ka mandatin e përcaktimit të vlerës së granteve duke zbatuar kriteret e përcaktuara, si: numri i popullsisë, numri i nxënësve, numri i pakicave kombëtare, etj.

Nga këto përcaktime të Komisionit të Granteve ka rezultuar se buxheti i organizatës sonë buxhetore për vitin 2027 do të ketë vlerën 79,118,940.00 €.

Njëri ndër segmentet më të rëndësishëm në procesin e hartimit të buxhetit është ai i përcaktimit të prioriteteve të përgjithshme zhvillimore. Vendosija e prioriteteve kërkon analizë dhe angazhim të qeverisë lokale, që së pari të identifikojë nevojat zhvillimore. Pra, është një segment tejet i rëndësishëm në kuadër të procesit buxhetor, andaj pikërisht për shkak të kësaj rëndësie që ka, Kryetari i Komunës i kushton shumë kujdes prioritetëve dhe kërkesave të qytetarëve.

Bazë e përcaktimit të prioriteteve janë nevojat e qytetarëve të komunës sonë, si dhe planifikimet zhvillimore të qeverisë lokale, të cilat janë në funksion të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve. Mbi bazën e këtyre nevojave, Kryetari i Komunës, së bashku me stafin e tij dhe në konsultim me qytetarët,

në varësi të mjeteve të disponueshme, ka përcaktuar prioritetet 2027–2029, me fokus ato të vitit fiskal 2027.

Kriter shumë i rëndësishëm është edhe identifikimi i nevojave duke parë gjendjen aktuale në terren, si në atë urbane, ashtu edhe në atë rurale, sa i përket investimeve në projektet infrastrukturore.

Komuna e Prizrenit, si mision të vetin, ka zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik sipas prioritetëve, duke siguruar ambient të sigurt dhe tërheqës për investitorët. Misioni i qeverisë komunale për periudhën afatmesme buxhetore është përshpejtimi i zhvillimit ekonomik, shtimi i mundësive për shkollim, avancimi në shërbimet shëndetësore, kulturë, rini dhe sport, në lëmin e bujqësisë, si dhe zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit dhe infrastrukturës komunale, si çështje më kryesore që mund të ndikojnë në përmirësimin e shpejtë të gjendjes ekonomike dhe shoqërore të banorëve të komunës.

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e nivelit qendror), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale. Buxheti Komunal i Prizrenit është në përputhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës dhe me kornizën makroekonomike të Kosovës, sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025–2027 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Sipas Qarkores së pare buxhetore nr. 2027/01 për komuna, të datës 15.05.2026, dhe në bazë të shënimeve statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2024, rezulton se Komuna e Prizrenit ka 147,246 banorë (30,505 më pak banorë se në regjistrimin e vitit 2011), dhe nga Komisioni i Granteve – MFPT, për vitin 2027, komunës sonë i është ndarë Grant Qeveritar në vlerë 62,279,445.00 €.

Tabela nr. 1. Krahësimi i Buxhetit 2025/2026

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Buxheti komunal 2026 (aktual)	75,645,313.00
2	Buxheti i propozuar 2027	79,118,940.00
	Ndryshimi	+ 4,073,628.00

Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhdimit të reformave në procesin buxhetor, buxheti komunal për vitin 2027 është planifikuar dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nënprogrameve buxhetore. Për të përmirësuar gjithëpërfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin në formulimin e buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Prioritet për financim kanë projektet që janë në vazhdim, që kanë filluar në vitet e mëparshme, gjatë këtij viti, si dhe ato që janë në harmoni me prioritetet e Komunës.

Burimet e financimit komunal për vitin 2027

Financimi komunal përbehet nga: Granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim para universitar, grantit specifik për shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, grantet e donatorëve dhe financim nga huamarrja.


